

Gjykata e Qarkut në Prishtinë

P. Nr. 605/2008

4 gusht, 2010

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, kolegji i përbërë nga kryetari i trupit gjykues, Arkadiusz Sedek, gjyqtar i EULEX-it, gjyqtari Malcolm Simmons, gjyqtar i EULEX-it dhe Hamdi Ibrahim, gjyqtar i Kosovës, si anëtarë të kolegjit, i ndihmuar nga procesverbal mbajtësja Svetoslava Savova, në çështjen penale kundër të pandehurit:

**Hasan Beqiri**, biri i Behramit dhe Ajmones, mbiemri i vajzërisë Mehollit, i lindur më 20 mars 1942 në fshatin Bajgorë, komuna e Mitrovicës, banor i përhershëm i fshatit Babimost, komuna e Obiliqit, tregtar, i martuar, baba i 11 fëmijëve, i ka të përfunduar katër vite të shkollës, i gjendjes mesatare ekonomike, shqiptar i Kosovës, në paraburgim nga 10 maji 2006,

I akuzuar për vepra penale si në aktakuzën e prokurorit publik, e paraqitur në gjykatë më 3 gusht 2006 dhe ndryshuar me gojë më 3 gusht 2010;

- 1) Vrasje e rëndë sipas nenit 147, paragrafi 1, pika 11 të LPK-së dhe
- 2) Pronësia, posedimi, kontroll ose përdorim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328, paragrafi 2 i LPK-së.


Pas gjykimit publik të mbajtur më 3, 10 dhe 14 dhjetor 2009, 10 shkurt 2010, 31 mars 2010, 8 dhe 23 prill 2010, 21 maj 2010, 15 qershor 2010 (rikonstruimi i vendit të ngjarjes), 3 dhe 4 gusht 2010, në prani të Prokurorit Publik të Qarkut z. Lulzim Sylejmani, të akuzuarit dhe avokatëve mbrojtës Shahin Bajgora dhe Xhafer Maliqi, shpall publikisht këtë:

### AKTGJYKIM

I pandehuri Hasan Beqiri me të dhënat personale si më sipër **është gjetur fajtor** për veprën penale të **vrasjes së rëndë** në bazë të nenit 147, paragrafi 1 pika 11 të Kodit Penal të Kosovës.

### Sepse

Më 10 tetor 2005, rreth orës 16:00, në fshatin Babinmost, komuna e Obiliqit, në parcelën e tokës e cila gjendet në rrugën kryesore Prishtinë - Mitrovicë, me dëshirë pas një grindjeje çasti, ka vrarë dhe Ardian Lecin dhe Dritan Lecin.



Në ditën në fjalë i pandehuri ishte duke lëvruar dhe mbjell grurë me ndihmën e shoferit të traktorit Aleksandar Trajković. Një mosmarrëveshje verbale filloi në mes Ardian, Dritan dhe Artan Lecit dhe të pandehurit Hasan Beqiri lidhur me pronësinë e tokës të cilën i pandehuri ishte duke e punuar. Pas mosmarrëveshjes verbale të pandehurin viktimat e tërhoqën nga fusha në rrugë anësore. Në asnjë kohë gjatë grindjes asnjëra viktimë nuk ishte e armatosur me kurrfarë arme të çfarëdo lloji. Viktimat e pastaj u larguan nga i pandehuri. Pasi viktimat e kishin larguar nga vendi, i pandehuri ishte i poshtëruar dhe i zemëruar. Ai u kundërpërgjigj duke e përdorur pistoletën "TT" të kalibrit 7,62 x 25mm, pa leje të vlefshme, dhe nga një distancë prej rreth 6-7 metra, shtiu tri (3) herë në drejtim të të ndjerit Ardian Leci ku si pasojë plumbat (2) i shkaktuan lëndime hemorragjike, përfundimin e funksioneve të aortës, penetrim të shpuar nga një plumb në gjoks dhe bark, si pasojë e të cilave ai vdiq më 11 tetor 2005 në ora 03.05, si dhe në drejtim të Dritan Lecit, të cilit me një plumb të vetëm i akuzuari i shkaktoi lëndime në kokë dhe në gjoks dhe, si pasojë e tronditjes, plagës hemorragjike dhe shpuese, Dritan Leci vdiq më 10 tetor 2005 në rreth 17,30 orë.

I pandehuri Hasan Beqiri është fajtor për vepër penale të pronësisë, kontrollit, posedimit ose përdorimit të paautorizuar të armëve në pajtim me nenin 328, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës.

### Sepse

Për një kohë të pacaktuar deri në datën 10 tetor 2005, i pandehuri Hasan Beqiri ka poseduar pistoletën "TT" të kalibrit 7, 62 x 25mm, pa leje të vlefshme për posedimin dhe përdorimin e saj.

Për arsyet e përmendura më sipër, kolegji lëshon këtë


### DËNIM

Në bazë të nenit 37 të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 147 paragrafi 1 pika 11, ai dënohet me njëzet e dy (22) vjet burgim;

Në bazë të nenit 38 dhe nenit 328 (2) të LPK-së, ai dënohet me burgim prej një (1) viti.

Në bazë të nenit 71 paragrafi 1 dhe 2, pika 1 të Kodit Penal të Kosovës, i pandehuri Hasan Beqiri do të shërbejë një dënim unik me njëzet e dy (22) vjet burgim

Kohën të cilën Hasan Beqiri e kaluar në paraburgim nga 10 Maj 2006 deri sa vendimi të marrë formë të prerë do të llogaritet si pjesë e dënimit me burgim në përputhje me nenin 73 të LPK-së.



## ARSYETIMI

### Historia procedurale

I pandehuri Hasan Beqiri u arrestua më 10 Maj 2006.

Prokurori Publik i Qarkut të Prishtinës ngriti aktakuzën PP. Nr. 770-1/2005, të datës 3 gusht 2006, kundër të pandehurit Hasan Beqiri për veprat e mësipërme penale.

Shqyrtimit i mëparëshëm (i parë) kryesor ka filluar më 12 janar 2007 para një koleji të përbërë nga pesë (5) gjyqtarë me kryetarin e trupit gjykues Raif Emini. Shqyrtimit gjyqësor pastaj ka vazhduar më 1 mars 2007, 20 prill 2007, 1 qershor 2007, 20 qershor 2007 dhe 22 qershor 2007.

Më 22 korrik 2007, koleji i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë e ka gjetur të pandehurin fajtor për dy akuza të vrasjes dhe pronësi, posedim, kontroll ose përdorim të paautorizuar të armëve. Koleji e dënoi atë me burgim afatgjatë njëzet e dy (22) vjet.


Më 27 gusht 2008, Gjykata Supreme e Kosovës urdhëroi rigjykim, duke vepruar në bazë të ankesave të mbrojtjes dhe prokurorisë. Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që i pandehuri të mbetet në paraburgim pa caktuar afat kohor për shqyrtimin e tij.

Më 3 korrik 2009, me kërkesën e avokatit mbrojtës të pandehurit Shahin Bajgora, kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it ia caktoi rastin gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Më 17 nëntor 2009, kryetari i trupit gjykues zhvilloi seancë dëgjimore mbi paraburgimin në bazë të 287 paragrafi 2 të KPPK-së dhe parimeve të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Palët u dëgjuan, mbrojtja kërkoi arrest shtëpiak dhe u deklarua për aftësinë e të paguarit të dorëzarisë në shumën e përcaktuar nga gjykata. Prokurori publik përsëriti nevojën për caktimin e paraburgimit në pajtim me ligjin. Kryetari i trupit gjykues vendosi se i akuzuari do të mbetet në paraburgim edhe dy (2) muaj të tjerë.

Rigjykimi kundër Hasan Beqirit ka filluar më 3 dhjetor 2009. Trupi gjykues dëgjoi leximin e aktakuzës dhe i pandehuri u deklarua i pafajshëm për akuzën e vrasjeve dhe fajtor për akuzën e posedimit të paligjshëm të armëve.

Rigjykimi vazhdoi më 10 dhjetor 2009. Trupi gjykues dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve: Rahman Leci, Artan Leci dhe Aleksander Trajkoviç.



Rigjykimi vazhdoi më 14 dhjetor 2009. Trupi gjykues dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve ekspert Dr. Tefik Gashi dhe Hazir Kelmendi.

Rigjykimi vazhdoi më 10 shkurt 2010. Trupi gjykues dëgjoi palët për pikëpamjet e tyre për të plotësuar procedurën e provave dhe vendosi të thërrasë personat në vijim: Remzi Halimi, Blerim Gashi, Bekim Gashi dhe Burim Osmanaj, të gjithë oficerë të Policisë së Kosovës.

Rigjykimi vazhdoi më 31 mars 2010. Seanca u desh të shtyhej për shkak të emërimit të Prokurorit të ri publik të cilit iu desht kohë të përgatitej për gjykim.

Rigjykimi vazhdoi më 8 prill 2010. Trupi gjykues dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve Remzi Halimi, Blerim Gashi, Bekim Gashi dhe Burim Osmanaj në cilësinë e tyre si oficerë të policisë hetuese.

Rigjykimi vazhdoi më 23 prill 2010. Trupi gjykues ftoi përsëri Burim Osmanajn dhe dëgjoi dëshminë e tij në lidhje me automjetin Golf II që ishte konfiskuar, rrobat e të ndjerit dhe nëse ishte gjetur një kaçavidë. Kolegji vendosi ne mes tjerash t'i administrojë si prova dokumentet e mëposhtme:

- Ekspertizën ligjore dhe balistike të Dr. Tefik Gashit dhe Hazir Kelmendit, i datës 1 qershor 2007 dhe skicën
- Raportin shpjegues/ plotësues të ekspertit të balistikës z. Hazir Kelmendi, i datës 16 dhjetor 2009 si dhe skicën me shpjegime shtesë;
- Raportin e autopsisë me ref. numër ZPZHF MA 05-174 lidhur me Dritan Lecin, i datës 30 tetor 2005 nga Dr Ananda Samarasekera;
- Raportin e autopsisë me ref ZPZHF-ja MA 05-175 lidhur me Ardian Lecim, i datës 10 nëntor 2005 nga Dr Ananda Samarasekera;
- Raportin laboratorik nr. 2010-0321, i datës 9 prill 2010 me referencë nr. 511-01-115/1-2545/10.VN nga Republika e Kroacisë, Qendra e shkencës për kriminalistikë dhe mjekësi ligjore, "Ivan Vuçetiç", departamenti i traseologjisë, bërë nga shefi i departamentit Vedran Nuić, B.Sc.

**Raportet e policisë:**


- Raportin e mjekësisë ligjore / sektori për vendngjarje i datës 14 tetor 2005 me ref nr. MHQF 05-2288 të nënshkruar nga Remzi Halimi (data 15.10.05) dhe Rifadije Vrajolli (date 21/10/05), skica dhe përshkrimi i fotografive, etiketuar nga 1-15, raport ky i datës 18 tetor 2005 nga oficer i policisë Bekim Gashi.

Procesverbalet e shqyrtimit të parë gjyqësor

12 janar 2007

1 mars, 2007

20 prill 2007



1 qershor 2007  
20 qershor 2007  
22 qershor 2007.

- Deklaratën e Artan Lecit të datës 23 maj 2006.
- Deklaratën e Aleksander Trajkoviqit të datës 1 gusht 2006.
- Deklaratën e Dragoljub Laziqit të datës 11 tetor 2005.
- Deklaratën e Milladen Laziqit datës 11 tetor 2005.
- Deklaratën e Hajzer Mustafës të datës 22 tetor 2005.
- Kontratën për shitblerje të pronës në mes të Dragoljub Laziqit si shitës dhe Behxhet Latifi si blerës; 2 faqet e zhvilluara më 20 shtator 2005 në Gjykatën Komunale të Prishtinës, me numrin referues VRNR 7435/2005.

Rigjykimi vazhdoi më 21 maj 2010. Trupi gjykues dëgjoi dëshminë e pjeshme të pandehurit Hasan Beqiri. Trupi gjykues lëshoi vendim se kishte nevojë për rikonstruktimin e vendit të ngjarjes dhe urdhëroi një gjë të tillë.

Më 15 qershor 2010, u zhvillua rikonstruktimi i vendit të ngjarjes. Ngjarja e datës 10 tetor 2005 u tregua nga i pandehuri dhe atëherë policia shënoi vendin e ngjarjes me shenja sipas dëshmisë së të pandehurit. Shenjat e dyta u bënë sipas raportit të policisë dhe skicës.


Rigjykimi vazhdoi më 3 gusht 2010. Trupi gjykues dëgjoi dëshminë e të pandehurit dhe fjalët përfundimtare të Prokurorit Publik, përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokatëve mbrojtës dhe të pandehurit. Trupi gjykues ka vendosur që **raporti i policisë** i përgatitur nga oficeri të policisë Xhemal Rexhepi më 14 tetor 2005 dhe deklaratën e dëshmitarit Dragoljub Laziq si dhe deklaratën e dëshmitarit Hazir Mustafa të **konstatohen si të lexuara në procesverbal dhe të pranohen si dëshmi**. Aktakuza së fundi u ndryshua dhe korrigjua me gojë gjatë shqyrtimit kryesor më 3 gusht 2010 për të përfshirë këto fjalë: **"pasi që pati një grindje aty për aty midis të pandehurit dhe tani dy të vdekurve Ardian Leci dhe Dritan Leci, dhe Artan Leci" ...**

Rigjykimi përfundoi më 4 gusht 2010, me shpalljen e vendimit nga ana e kryetarit të trupit gjykues vetëm.

### Konstatimi i gjendjes faktike

Gjykata i konstatoi këto fakte:

I pandehuri Hasan Beqiri ka jetuar në Gjermani që nga viti 1984 dhe është kthyer në Kosovë në vitin 2002.



I pandehuri Hasan Beqiri la shkuar tek toka ku ka ndodhur ngjarja në ora 08:30, më 10 tetor 2005 me Aleksander (Aca) Trajkoviçin i cili ka ardhur me traktorin e tij për të lëvruar tokën në mënyrë që Hasan Beqiri të mund të mbjellë grurë.

Toka është gjendet në magjistralen Prishtinë – Mitrovicë, në fshatin e Babinmost.

Hasan Beqiri dhe Aleksander Trajkoviçin e kanë punuar atë tokë pandërprerë, me udhëtime herë pas here për të mbledhur mjete dhe materiale, deri rreth orës 16.00, kur të tre vëllezërit Leci arritën, pra Dritan Leci, Artan Leci dhe Ardian Leci. Vëllai Leci arriti me automjetin ËV Golf II, në ngjyrë të bardhë me targë regjistrimi 125-KS-143.

I pandehuri Hasan Beqiri posedonte pistoletën e tij "TT" të kalibrit 7,62 x25mm në çdo kohë gjatë ngjarjeve në fjalë, pa leje të vlefshme. Hasan Beqiri e kishte telefonin e tij celular me veti në çdo kohë.

Pronësia e tokës ishte e pa definuar në kohën e ngjarjes në fjalë. Familja Leci tokën e konsideronte si pronë të tyre, pasi ata e kishin negociuar blerjen e saj rreth 17 janarit 2001, por më vonë një gjë e tillë dështoi. Në vend të kësaj palët kishin rënë dakord për një qira prej 5 vjetësh me familjen Leci duke e pasur mundësinë e parë për ta blerë atë nëse pronari Dragoljub Laziq do të vendoste ta shesë. Tokën më vonë e bleu Behxhet Latifi nga Dragoljub Laziq më 20 shtator 2005.


Hasan Beqiri e ka punuar tokën në marrëveshje me Behxhet Latifin.

Më 10 tetor 2005 rreth orës 16:00, në fshatin Babinmost, komuna e Obiliqit, Ardian Leci dhe Dritan Leci u vranë. Në atë kohë i pandehuri ka qenë duke lëvruar dhe mbjellur grurë me ndihmën e shoferit të traktorit Aleksandar Trajkovic. Një mosmarrëveshje verbale filloi në mes Ardian, Dritan dhe Artan Lecit dhe të pandehurit Hasan Beqiri lidhur me pronësinë e tokës në fjalë.

Pas mosmarrëveshjes verbale, të pandehurin viktimat e tërhoqën zvarrë jashtë arës për ta çuar në anë të rrugës. I pandehuri u zemërua ndaj vëllezërve Leci dhe e përdoruri pistoletën e tij "TT" të kalibrit 7,62 x 25mm, pa leje të vlefshme, dhe nga një distancë prej rreth 6-7 metra, shtiu tri (3) herë në drejtim të të ndjerit Ardian Lecit dhe në drejtim të Dritan Lecit. I treti vëlla Artan Leci për fat të mirë iku i padëmtuar nga këto ngjarje.

Ardian Leci u godit nga dy (2) plumba që i shkaktuan atij lëndime hemorragjike, përfundimin e funksioneve të aortës, penetrim të shpuar nga një plumb në gjoks dhe bark si pasojë e të cilave ai vdiq më 11 tetor 2005 në ora 03.05.

Dritan Leci u godit nga një plumb i vetëm që i shkaktoi lëndime në kokë dhe në gjoks



dhe, si pasojë e tronditjes, plagës hemorragjike dhe shpuese, Dritan Leci vdiq më 10 tetor 2005 në rreth 17,30 orë.

Artan Leci gjatë ngjarjes ishte strehuar në një gropë dhe nuk pësoi lëndime fizike.

Shoferi i traktorit Aleksander Trajkoviç, duke vënë re se disa mosmarrëveshje po ndodhnin aty dhe duke pasur frikë për sigurinë e vet personale, e kishte drejtuar traktorin e tij nga ara dhe u nis kah shtëpia e vet. Ai nuk deshë të përzihet; ishte argat i paguar atë ditë.

Mbrojtja e të pandehurit ishte se ai ka vepruar në vetëmbrojtje. Ai tha se një nga vëllezërit e Leci kishte ardhur kah ai me një kaçavidë të madhe. Nuk ka asnjë provë në dosjen e lëndës me të cilën do të sugjerohej se ka pasur kaçavidë në makinë, ose të jetë gjetur në atë arë.

I pandehuri Hasan Beqiri, pasi ka qëlluar të dy viktimat, iku nga ara dhe shkoi në shtëpinë e tij në Babinmost, ku ai i ndryshoi rrobat e tij, bëri një dush. Ai më pas bëri disa përgatitje për të shkuar në aeroportin e Tiranës në Shqipëri dhe nga atje për të ikur në Gjermani. Gjatë rrugës për në Shqipëri, ai u lirua nga arma e tij, pasi e kishte kaluar kufirin dhe të gjitha kontrollet e sigurisë në kufi.


I pandehuri ia ka dërguar dy fotografi avokatit të tij, Shahin Bajgora, për vëmendjen e prokurorit publik, Lulëzim Sylejmani, të cilat mbanin pulla postare të Norvegjisë dhe vulën e PTK-së së Prishtinës me datën 11 nëntor 2005.

I pandehuri Hasan Beqiri vendosi t'i dorëzohet Policisë së Kosovës dhe udhëtoi për në Kosovë dhe u arrestua në Aeroportin e Prishtinës më 10 Maj 2006.

### Vlerësimi ligjor

Trupi gjykues ka konstatuar se i pandehuri Hasan Beqiri nuk ka vepruar në mbrojtje të nevojshme kur e kishte kryer vrasjen e Ardian dhe Dritan Lecit. Trupi gjykues nuk ka gjetur elemente të mbrojtjes së nevojshme në veprimet e të pandehurit sipas nenit 8 të KPK-së. Viktimat nuk ishin të armatosura. I pandehuri Hasan Beqiri ka shkuar në arë me armën e tij në bel.

Trupi gjykues ka gjetur se edhe në qoftë se vëllezërit Leci kanë përdorur forcë për ta hequr të pandehurin nga toka në fjalë, jeta e të pandehurit nuk ka qenë kurrë në rrezik. I pandehuri nuk ka ndër marrë kurrfarë veprim për t'iu shmangur përdorimit të armës së tij dhe kryerjes së vrasjeve, edhe kështu ai kishte mundësi të largohet nga toka aty, kishte mundësi ta thërras dikë për ndihmë duke përdorur telefonin e tij celular. Trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë dëshmi se është përdorur një kaçavidë siç pretendon i



pandehuri. Sipas mendimit të trupit gjykues, nuk kishte prova me të cilat do të sugjerohej se i pandehuri ishte rrahur nga vëllezërit Leci. E vetmja forcë e përdorur nga vëllezërit Leci ishte ajo e përdorur gjatë largimit të të pandehurit nga toka në fjalë.

Fotografite e paraqitura si dëshmi të dhunës e cila është bërë mbi të pandehurin u konstatuan nga trupi gjykues të mos jenë të besueshme dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si mbështetje .


Trupi gjykues gjeti se elementet e mbrojtjes së nevojshme nuk ekzistojnë nga këndvështrimi objektiv për shkak të faktit se i pandehuri ka shkuar ta punojë tokën i armatosur dhe trupi gjykues konsideron se edhe në qoftë se kishte frikë për jetën e tij kur po shtinte në Adrian Lecin (viktima e parë ), elementi i rrezikut të menjëhershëm për jetën e tij ka pushuar së ekzistuari ose është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme. I pandehuri ka vazhduar dhe ka shtënë në viktimën e dytë (Dritan Leci). Vendin i krimit ishte afër rrugës kryesore, e cila frekuentohet nga makina dhe njerëz, afër aty gjendej një restorant ku ai ka mundur të kërkojë asistencë ose ndihmë.

Për më tepër i pandehuri haptazi ka pranuar në gjykatë se ai nuk kishte frikë nga askush përpos nga Perëndia, me të cilën arrihet përfundimi se ai nuk ka mundur të ketë frikë nga vëllezërit Leci në atë masë të cilën e kërkojnë dispozitat e mbrojtjes së nevojshme.

Trupi gjykues është i bindur përtej çdo dyshimi se faktet e konstatuara në këtë procedurë penale nuk mund të konsiderohen si **mbrojtje e nevojshme** sipas nenit 8 të Kodit Penal të Kosovës që thotë: "*.... Nuk është veprë penale vepra e cila është kryer në mbrojtje të nevojshme*". Më tej gjatë përcaktimit ligjor mbrojtja e nevojshme përshkruhet si vijon: "*...Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëqasshëm ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.*"

Afatit ligjor i mbrojtjes së nevojshme kërkon dy baza dhe pjesë përbërëse të domosdoshme: sulm-atakim dhe rezistencë ndaj sulmit. Të dyja këto elemente duhet të realizohen në kushte të caktuara. Sa i përket sulmit, kjo është faza e parë dhe fillestare e mbrojtjes së nevojshme. Ky është një veprim i ndërmarrë nga personi nëpërmjet të cilit vlerat e mbrojtura ligjërisht të një personi tjetër dëmtohen apo rrezikohen. Prandaj, pasoja objektive, që do të thotë, dëmtimi ose rrezikimi i disa vlerave të duhet të ndodhë. Në mënyrë që një sulm të tillë të mund të konsiderohet si i rëndësishëm në kuptimin e mbrojtjes së nevojshme, ai duhet të realizohet sipas kushteve të mëposhtme.

Sulmi duhet të jetë **i vërtetë** dhe ky kusht duhet të vlerësohet në bazë të kriterit objektiv-subjektiv. Nga pikëpamja e kriterit subjektiv, sulmi është i vërtetë kur sulmuesi



është në dijeni të se po ndërmerr një veprim me të cilin vlerat e mbrojtura me ligj po rrezikohen, dhe në kuptimin objektiv sulmi është i vërtetë sepse ai veprim mund me të vërtetë t'i shkaktojë pasojat e deklaruara. Kjo nënkupton se sulmi duhet të drejtohet drejt disa vlerave të mbrojtura me ligj, për t'i numëruar disa prej me të rëndësishmeve: jeta, shëndeti dhe integriteti i trupit.

Përveç kësaj, sulmi duhet të jetë i paligjshëm e kjo do të thotë se kryesi i cili ndërmerr veprime me të cilat vlerat e mbrojtura me ligj të personit tjetër shkelen ose rrezikohen, nuk ka pasur autorizim ligjor për një sjellje të tillë.


Për më tepër, sulmi duhet të jetë i **atypëratyshëm** në kuptimin se sjellja e sulmuesit ka rezultuar në synimin e tij për të sulmuar, kur ai supozon sjellje të caktuar, e cila objektivisht e vlerësuar tregon se sulmi është i pashmangshëm.

Zmbrapsja e sulmit, që do të thotë, **mbrojtja**, është pjesa përbërëse e dytë e mbrojtjes së nevojshme. Ky është veprimi i ndërmarrë nga personi i sulmuar që drejtohet kundër sulmuesit, në mënyrë për të zmbrapsur sulmin dhe për të mbrojtur vlerën e rrezikuar, përkatësisht jetën dhe integritetin trupor. Është thelbësore që mbrojtja duhet të zhvillohet në përputhje me kushtet në vijim:

Mbrojtja duhet të drejtohet kundër sulmuesit dhe qëllimit i tij themelor duhet të jetë **neutralizimi i sulmit**. Derisa bëhet kjo, një kategori e caktuar të vlerave të mbrojtura me ligj që i përkasin sulmuesit (jeta, integriteti trupor) duhet të shkelen dhe me këtë akt thelbi e një vepre penale të jetë i plotësuar, për shembull, sulmuesi vritet apo shkaktohen lëndimeve trupore. Vetëm atëherë mbrojtja e nevojshme i gjeneron efektet e saj si koncept i ligjit material penal.

Së dyti, mbrojtja duhet të jetë e **njëkohshme** me sulmin. Në këtë kuptim, është e mundur të dallojmë dy situata: kur fillon sulmi apo po fillon të ndodhë në mënyrë të pashmangshme, me fjalë të tjera se sulmi është gati për të ndodhur. Në rastin e parë, e drejta për mbrojtje lind nga momenti kur filloi sulmi dhe për atë kohë sa zgjat. Se a ka filluar sulmi ose është ende duke zgjatur është çështje faktike e cila zgjidhet në mënyrë të ndryshme për çdo rast të veçantë, duke pasur parasysh kushtin e përgjithshëm të një sulmi si një aktivitet (veprim ose mosveprim), i cili ka për qëllim ta dëmtojë pasurinë e dikujt. Nuk është e mundur të thirremi në njëkohshmërinë e mbrojtjes me sulmin, pasi sulmi të jetë ndalur dhe të ketë përfunduar. **Përveç kësaj nuk ka vend për të pretenduar mbrojtje të nevojshme në rastin kur personi i sulmuar dëmton sulmuesin për shkak të frikës së hakmarrjes, si në këtë rast.**

Së treti, mbrojtja duhet të jetë e domosdoshme në kuptimin e asaj se është e nevojshme për t'i bërë ballë sulmit të paligjshëm i cili ndodh në të njëjtën kohë. Ideja e kësaj dispozite ligjore është se gjatë rezistencës ndaj sulmit të paligjshëm, duhet të përdoret mbrojtja sa më e përmbajtur që është e mundshme dhe që pasuria e sulmuesit të mos



jetë e dëmtuar më shumë se sa është e nevojshme: me fjalë të tjera mbrojtja duhet e një ashpërsie më të vogël e më, përkatësisht vlerat mbrojtura me ligj të sulmuesit të dëmtohen vetëm në atë masë sa është e nevojshme. Megjithatë, është e pamundur për të dhënë një përkufizim të përgjithshëm të mbrojtjes në rast kur mbrojtja është absolutisht e nevojshme. Kjo çështje duhet të vlerësohet në secilin rast veç e veç. Prandaj, në mënyrë që të vlerësohet nëse ka mbrojtje të nevojshme, duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat gjatë të cilave sulmi dhe mbrojtja kanë ndodhur e pastaj duhet të arrihet tek përfundimi logjik dhe i arsyeshëm lidhur me atë se personi i sulmuar a ka vepruar në mënyrë dhe kushte të cilat bien brenda dispozitës ligjore të mbrojtjes së nevojshme.

Sulmuesi do të konsiderohet përgjegjës për kryerjen e veprës derisa i ka tejkalluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme; po qe se eksesi është paramenduar, ai do të jetë përgjegjës për secilën veprë të kryer.


Duke marr parasysh të gjitha analizat e lartpërmendura ligjore pas vlerësimit të vëmendshëm të të gjitha provave të mbledhura gjatë gjyqimit, Trupi gjykues ka ardhë në përfundim se i pandehuri Hasan Beqiri nuk ka vepruar në mbrojtje të nevojshme gjatë kryerjes së vrasjes së e Ardian dhe Dritan Lecit. Bile as që ka baza për të supozuar se i pandehuri ka tejkalluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme.

Prova më e rëndësishme që është dashtë të vlerësohet për ta vërtetuar se mbrojtja e nevojshme nuk ka ekzistuar dhe se i pandehuri nuk i ka tejkalluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme në këtë rast, ka qenë deklarata e dhanë nga Hasan Beqiri.

Gjatë marrjes në pyetje me datën 21 maj dhe 3 gusht 2010 Hasan Beqiri ka dhanë dëshminë dhe e ka parashtruar versionin e tij të ngjarjeve në ditën kritike. Duke ju referuar rrethanave para vrasjeve ai ka deklaruar se Hasan Beqiri ka shkuar te ara në ora 08:30 me Aca Trajkovic i cili kishte ardhë me traktor. Ai e ka ditë se tokën e ka ble Behxhet Latifi (ndonjëherë përmend edhe Sallahu gjithashtu) nga Dragoljub Lazic. Një pjesë e arës ka qenë e mbjellë me lakër dhe purri. Aca e punonte tokën me traktor, ndërsa Hasan Beqiri kujdesej që ajo të bëhej në mënyrë të duhur. Një herë Hasani dhe Aca kanë shkuar nga aty për të marrë makinat për farë. Deri sa Hasani shikonte mbjelljen e farës, një veturë është ndalur nja 25 – 30 metra nga rruga dhe tre (3) persona kanë dalë nga vetura. Është ba ndërrimi i fjalëve të rënda mes tyre. Hasani nuk i ka njohtë këta persona të cilët i flisnin këto fjalë. Pasi që Hasani ju ka sqaruar se tokën e ka ble Behxhet Latifi, më i vjetri nga viktimat e ka kapë të pandehurin për fyti. Hasani nuk ka pa se a mbanin ata diçka në duart e tyre. Kur i janë afruar të pandehurit, ai ka qenë 5 metra brenda në arë. Si pas të pandehurit i dyti ka qenë i trashë, dhe ai ka qenë ai i cili e ka kapë për fyti, dhe dy të tjerët ja kanë vu kapelën mbi kokë dhe gjithashtu ja kanë vu edhe pallton mbi kokë, dhe ai nuk ka mund të shoh sepse ata kanë filluar ta qëllojnë ate me grushta. Për këtë shkak ai ka pasë mavijosje në të tërë trupin e tij. Ata e

kanë tërheq për toke nja 5 – 6 metra dhe ai e ka ditë se po e qojnë diku, por nuk ka mund të shoh sepse ja kishin vendosë pallton mbi kokë. Ata e ka lanë Hasanin me fytyrë për toke dhe sulmuesit (viktimat) janë nisë në drejtim të Acës. Aca ka qenë përafërsisht 40 metra larg nga pandehuri. Hasan Beqiri e ka pasë me vete armën e tij dhe telefonin mobil në kohën e sulmit. Ata kanë shku në drejtim të Aca Trajkovic, dhe kur Aca Trajkovic ka ikë, më i vjetri nga ata e ka përdorë rrugën e shkurtë për të ardhë te ara dhe e ka marrë me vete një kaçavidë. Largësia në mes të veturës dhe vendit ku kanë shkuar në drejtim të Aca Trajkovic ishte rreth 70 metra. Më vonë Hasan Beqiri ka deklaruar se më i vjetri shante ndërsa i dyti e ka kapë për fyti. Edhe pse Hasan Beqiri e kishte me veti telefonin mobil të tij ai nuk ka mund ta thërras policinë sepse sulmuesit nuk i kanë dhanë kohë për asgjë dhe nuk ka mund të vlerësoj kohën prej kur sulmuesit kanë dalë nga vetura dhe janë kthyer për ta marrë kaçavidën. Ata kanë ecë ngadalë, por personi i cili ka shku për ta marrë kaçavidën ka vrapuar, ndërsa dy të tjerët kanë ecë ngadalë. Në pyetje të Prokurorit publik se janë takuar këta të tre në ndonjë moment sepse keni thanë se dy të tjerët kanë ecë ngadalë. Hasan Beqiri është përgjigj *“kur kanë ardhë të më sulmojnë nga dy anët ne të gjithë aty jemi takuar.”* Duke i shpjeguar rrethanat se pse e ka përdorë armën, i pandehuri ka sqaruar se ai nuk ka shtie menjëherë; ai i ka paralajmëruar sulmuesit se ai ma nuk mund ti qëndroj rrahjet. Ata kanë qenë larg 7 metra kur Hasan Beqiri ka shtie në ajër, personi me kaçavidë ka ardhë nga ana e djathtë ndërsa dy personat tjerë të cilët nuk kanë pasë asgjë në duart e tyre, por personi tjetër e mbante kaçavidën, atëherë është ba e shtëna e dytë në ajër, ai ka paralajmëruar se po qe se nuk e ndërpresin rrahjen i pandehuri do të shtie në ta. Nga distanca prej 4 metrash Hasani ka shti një herë para këmbëve të më të vjetrit, dhe nga dy metra Hasani ka shtie drejtpërdrejtë në te nga pozita poshtë nga brezi, viktimë ka ardhë në një metër largësi dhe Hasani ka shti përsëri në te dhe atëherë njeri nga sulmuesit është ndalur dhe ka ra në tokë. Dy tjerët nuk kanë qenë as 30 cm larg nga Hasani dhe ai ka gjuajtur vetëm një herë dhe viktimë ka ra, ndërsa më i riu nga ata vetëm i ka ngritë duart lartë.

I pandehuri në deklaratën e tij e ka informuar trupin gjykues me informatat në lidhje me ata se çka ka ndodhur pas të shtënave në atë ditë kritike. Ai ka thanë se ai menjëherë është kthyer dha ka shkuar në rrugën kryesore. Sipas të pandehurit ai është munduar të shoh se a mund ta ndalë ndonjë veturë që kalonte aty pari për ti dërguar viktimat në spital. Por mu në ato momente ai nuk ka pa asnjë veturë. Asi ka pritë rreth një minute e gjysmë dreri dy minuta por askush nuk ishte aty pari. Më vonë ai u kthye te vendi dhe shikoj përsëri atje. Ai ka pa se vëllai më i vogël mundohej ti ndihmonte vëllezërit e vet që ishin të plagosur. Kur e ka pa këtë, atij i ka ardhë shumë keq. Ishte sikurse djemtë e tij ishin të shtrirë aty. Edhe pse i pandehuri e kishte telefonin mobil me vete, ai nuk ka thirr për ndihmë dhe as që ka menduar për këtë mundësi. Gjithashtu ai nuk ka menduar për ate që ti sjell të plagosurit në spital me veturën e tyre pasi që ai as nuk ka leje për vozitje dhe as që din si të drejtojë veturën. Pas kësaj ai ka shkuar nja 40 metra në fushë dhe ka pa veturat që kishin arrit, dhe atëherë ai ka shkuar në shtëpi të tij.




**Pasi që ka mbërri në shtëpi, ai ka shkuar që të pastrohet dhe ti ndërroj rrobat.** Për këtë çështje me rëndësi të posaçme ai ka dëshmuar: *“rrobat e mia i kam lanë në shtëpi, përpos palltos. Ate e kam marr me vete sepse ishte bukur ftohtë. Kur kam shkuar në Rinas, e kam harruar në veturën e personit nga Durrësi, dhe asnjëherë nuk ka mund ta gjejë ate”.*

Ai nuk kishte dijeni për ndonjë lëndim në trupin e tij sepse e kishte të lënduar fytin. Kur ka ndier ujë në trupin e tij ai ka kuptuar se për shkak të dhimbjes se në çfarë gjendje të keqe ishte. Në pyetjen se pse nuk ka kërkuar ndihmë mjekësore, i pandehuri ka sqaruar se ai nuk ka dashtë të kërkoj ndihmë mjekësore nga askush sepse e kishte familjen në Gjermani. Ai dëshironte që të shkoj atje dhe të kërkoj ndihmë dhe të shërohet. Hasan Beqiri e ka marr pasaportën dhe paratë dhe ka shkuar me një taksi. Ai i ka treguar vozitësit se duhej të shkoj në Prizren pasi që donte të shkonte në Shqipëri, pasi që e kishte gruan e sëmur dhe ajo ishte në Gjermani. Ai nuk dëshironte që taksisti ta kuptonte të vërtetën. Kur kanë mbërri në Prizren i pandehuri i la sqaruar taksistit se i duhej të shkojnë Rinas – Aeroporti në Shqipëri, sepse donte të shkonte në Gjermani. I pandehuri u deshtë ta ndërroj taksin, pasi që taksisti nuk e kishte pasaportën me vete. Hasan Beqiri ka vazhduar rrugën e vet në Morinë me taksin e dytë.

Duke ju referuar çështjes së armës, ai ka sqaruar si vijon: *“kur kemi mbërri në një vend që quhet Fushë Arëz, ku një student nga Malisheva është vra, ai më ka than, ‘këtu është vendi ku ka ndodhur.’ Unë i kam thanë “të lutem ndale veturën sepse kam disa nevoja personale.” Ma së pari kam urinuar dhe mandej e ka udhë poshtë revolen time. Aty është nja 150 deri 200 thellë. Aty është vendi ku e kam hedhë. Pos kësaj, ai e ka vërtetuar se revolen që e ka përdorë në ditën kritike ai e ka qe 45 vite.*

Sipas të pandehurit, ai është ndaluar në kufi, pasaporta i është kontrolluar dhe ai është lejuar që të hyj në Shqipëri. Nga një kafe në Shqipëri, Hasan Beqiri e ka thirr vëllain e tij dhe i ka pranuar se ka kryer këtë vepër penale. Ai ika thanë vëllait: *“As që i njoh ata; ata më kanë sha dhe e di se janë nga familja Leci”.* Ai ka shtuar edhe këtë: *“Shko te Osman Shala edhe tregoj atij të gjitha, sepse nuk dua që njerëzit të thonë se kështu dhe kështu ka ndodhë e ai mandej i ka lanë të gjitha e të gjithë e ka ikë”.* Taksisti nga Kukësi më ka pyetur, *“A do të vazhdosh me këtë personin tjetër pasi që ai është nga Durrësi, që të mos shkojmë me dy vetura?”* Mandej ai ka vazhduar rrugën e tij me taksistin tjetër dhe ka shkuar drejtpërdrejt në Aeroportin Rinas. Në ora 06:00 në kafene duke pritë të hapet Aeroporti në ora 08:00. I pandehuri ka ble biletën për Shtuttgart . kishte vend të lirë për aeroplanin e orës 11:30. Në Gjermani ka shkuar te familja e vet, dhe atje: *“E kam shëruar veten me barna sepse më ka ardhë marre të shkoj te mjeku sepse këtu të gjithë më njohin deh kam ba shumë gjëra të mira, pra me shku te mjeku në atë gjendje dhe ti tregoj se çka ka ndodhë, më ka ardhë turp ta bëj ate. Gjatë 45 ditësh unë kam mund të haj vetëm supë dhe bukë me tambël dhe kam mund të përdori vetëm lugë të plastikës për të nganë, të njejtat sikurse që i kemi këtu në burg. Nuk kam qenë në gjendje të haj*




*me lugë normale dhe ushqim normal.*" Sipas mendimit të pandehurit nuk ka pasë nevojë që të vizitohet mjeku, nga arsyeja e thjeshtë sepse gruaja e tij punon në farmaci dhe ajo i siguron barnat që i nevojiteshin, përfshirë edhe antibiotikët dhe barnat për tension.

Sa i përket fotove të cilat gjoja se i përshkruajnë lëndimet e tija që i ka pësuar pas rrahjes, i pandehuri ka shpjeguar se ato janë ba nga i biri i tij, ditën e të nesërme kur ka mbërri në Gjermani. Kur është pyetur se pse këto foto nuk e tregojnë edhe fytyrën e tij, ai ka shpjeguar se ai nuk dashtë që ta paraqesë vetën organeve në atë kohë. Pos kësaj, i pandehuri është pyetur se pse në anën tjetër të fotografive është shënuar data 03.11.2005, ndërsa sipas deklaratës së tij data duhej të ishte 12.10.2005, dhe me shpjegimin e tij ai ka treguar se i biri i tij i ka zhvilluar këto fotografi me anë të kompjuterit dhe mandej këto fotografi janë fotokopjuar.

Sa i përket çështjes kontestuese të pronësisë së tokës të pohuar nga ana e familjes Leci, i pandehuri ka treguar se ai ka qenë ndërmjetësues gjatë negociatave. Sipas tij, ai vetëm është informuar se në ndërkohë dikush po punonte arën, po kultivonte purri dhe lakër, dhe kjo është e tëra që i ka thanë atij dhe shitësit. Hasan Beqiri ka theksuar më tej se nuk ka ditur asgjë në lidhje me mosmarrëveshjes për pronësinë e tokës.

Duke e shqyrtuar me vëmendje deklaratat e dhëna nga i pandehuri dhe pasi që janë marrë parasysh të gjitha provat e mbledhura gjatë gjyqimit, trupi gjykues ka ardhë në përfundim se ato nuk janë të besueshme; janë jo logjike, të izoluar dhe nuk përputhen me provat e tjera, përpos faktit kur i pandehuri ka pranuar se i ka vra vëllezërit Leci. Duhet të theksohet se edhe pse i pandehuri pohon se kjo lëndë ka të bëjë me mbrojtje të nevojshme sipas dispozitave juridike të Kodit penal të Kosovës, kjo nuk do thotë se ne duhet të jemi të kënaqur vetëm me këtë sqarim, por duhet të merren parasysh: *"Çdo provë veç e veç dhe në lidhje me njëra tjetrën dhe në bazë të këtij vlerësimi të arrihet deri te konkludimi se a është vërtetuar apo jo ndonjë fakt i veçantë"* (Neni 387, paragrafi 2 i KPPK).

Në procesin e rikonstruktimit të zinxhirit të ngjarjeve dhe vërtetimit po qe se i pandehuri ka vepruar në situatë specifike në mbrojtje të nevojshme, prova më e rëndësishme është mendimi i ekspertit nga dëshmitari ekspert prof. Hazir Kelmendi – ekspert i balistikës forensike dhe Dr. Tefik Gashi, ekspert i Patologjisë forensike. Dëshmitarët ekspert e kanë dhanë mendimin pas analizimit të lëndës dhe pjesëmarrjes në rikonstruktimin e ngjarjes që është ba me datën 5 qershor 2010. Ekspertët kanë ardhë deri te konkludimi i pashmangshëm për pozitën e të pandehurit për vendin dhe largësinë nga e cila i pandehuri ka gjuajt në viktimat. Është shpjeguar qartazi nga ekspertët se: *"Është vërtetuar se të shtënat në ditën kritike, nga arma e kalibrit. 7,62 x 25 mm, e cila ka qenë e të akuzuarit, janë shti nga një stom i dheut – skaji i rrugës, por jo nga pozita nga e cila pohon i akuzuari, por më poshtë, më afër rrugës për një 2,5 metra."* Pos kësaj, prof. Hazir Kelmendi dhe Dr. Tefik Gashi kanë konfirmuar se: *"Është*




*vërtetuar se personat e ndjerë janë privuar nga jeta e tyre kur i akuzuari ka shti me armë nga pozita pa e lëvizur armën, por duke e lëvizë vetëm dorën.” Sa i përket largësisë nga e cila i pandehuri ka shti në viktimat, dëshmitarët ekspert kanë deklaruar: “(…), kemi ardhë në përfundim se në ditën kritike, duke u bazuar në vizatimin vendit të ngjarjes, në ditën kritike, i akuzuari ka qenë në arën e lëvruar afër përgju dhe e cila e ndanë arrën e lëvruar me rrugën dytësore fshatit dhe ka shti me armë zjarri në drejtim të tani të ndjerëve para tyre nga largësia 6,30 – 7 metra. Gëzhojat kanë dalë jashtë njera ngatë tjetrës në anën e djathtë ashtu sikurse që shihet në vizatim dhe foto – dokumentacion.”*

Mendimi ka rëndësi vendimtare për përcaktimin se në këtë lëndë nuk ka pasë elemente të mbrojtjes së nevojshme. Sikurse që është elaboruar më herët, i pandehuri ka pohuar se ai është sulmuar nga vëllezërit Leci, të cilët e kanë rrahur dhe e kanë qitë skaj rruge, ku ka mbet i shtrirë për toke dhe më vonë është ngritur në këmbë. Ai ka mbet në të njëjtën pozitë dhe sipas tij sulmuesit janë munduar që ti afrohen që të vazhdojnë ta rrahin. Ndërsa sipas ekspertëve i pandehuri është tërheq zhagas edhe më poshtë, më afër rrugës për 2.5 metra. Duhet të nënvizohet se mendimet përputhen me deklaratën e dëshmitarit Aleksandar Trajkovic (vozitësit të traktorit) i cili ka deklaruar me 10 dhjetor 2009; “Aleksander Trajkovic: Të parën herë kur jam kthyer e kuptova se bëhej një debat dhe herët tjera që kam shikuar kam pa se debati nxehej. Pas kësaj kam pa 3 persona, njeri pakës më i ndarë nga dy tjerët, dhe dy personat e tërhiqnin zhagas personin e tretë nëpër fushë.” Kjo provë tregon qartazi dhe mbi çfarëdo dyshimi se qëllimi i vëllezërve Leci ka qenë që ta nxjerrin Hasan Beqirin nga ara, pasi që e konsideronin njeri i paftuar në tokë të tyre. Zhvillmi i mëtejme i ngjarjes qartazi tregon se më vonë ata dëshironin që ta nxjerrin jashtë edhe traktoristin nga toka të cilën ata e kanë konsideruar pronë e familjes. Arsyetimi i pastër dhe logjik sjell deri te një përfundim i mundshëm se po qe se vëllezërit Leci të kishin pasë qëllim për të vra të pandehurin ata do ta kishin vra të pandehurin para syve të dëshmitarit okular - **Aleksander Trajkovic**.

Po qe se i pandehuri pohon se Leci dëshironte tasi vras, ai e bën këtë për një arsye – kjo është arsyetim i vetëm, duke thanë se ai dëshiron në mënyrë të paarsyeshme të arsyeton përdorimin e armës së vet. Kjo është arsyeja të cilën ai e ka parashtruar në vendin e ngjarjes, kaçavida e supozuar e cila sipas mendimit të tij ka mund ta arsyetoj sulmin e vërtetë dhe të çastit që nevojitet për vërtetimin e mbrojtjes së nevojshme.

Nuk i është shmangur vërejtjes së këtij trupi gjykues se i pandehuri ka pasë mjaftë kohë të përgatisë tregimin e tij për mbrojtje pasi që ai thjeshtë ka ikur nga vendi i ngjarjes, as pa u munduar që ti ndihmoj viktimave, dhe i është shmangur sistemit juridik të Kosovës. Për shkak të sjelljes së tij të pahijshme pas vrasjes, ai thjeshtë nuk mund të gëzon përfitim nga kjo situatë dhe të prezantoj rrjedhën e ngjarjes në mënyrë të pabesueshme, por përkundrazi shkakton që trupi gjykues obligimin që të kryej analizë të hollësishme të të gjitha provave që janë mbledhur gjatë gjykimit.




Edhe një çështje që rrjedhë nga mendimi i ekspertëve, që është vendimtar nga pikëpamja e mbrojtjes së nevojshme, është mënyra se si i pandehuri e ka përdorë revolen. I pandehuri është munduar në mënyrë të pasuksesshme që të jap deklaratën e tij si dëshmitar okular dhe nga mënyra e shpjegimit ka treguar se kur i janë afruar në largësi prej 5 metrash ai ka shti në ajër por për fat të keq sulmuesit nuk janë ndalur. Nga frika e sulmit të çastit, kur personi me kaçavidë i është afruar në dy metra largësi, ai ka shti në trup dhe ai është rrëzuar në tokë pranë tij. Në të njejtën kohë dy sulmuesit tjerë i janë afruar në 30 cm dhe sipas të pandehurit ata dëshironin që ta qëllonin. Hasan Beqiri ka shti në gjoks të sulmuesit të dytë dhe ai është rrëzuar në shpinë.

Sikurse që është theksuar më lartë, dëshmitarët ekspert i kanë parashtruar konkludimet objektive që janë kundërshtim me deklaratën e dhanë nga i pandehuri. Nga mendimi i ekspertëve del se viktimat kanë qenë më larg se Hasan Beqiri në kohën kur ai ka shti në ta. Në bazë të këtij mendimi dhe deklaratës së dhanë nga Artan Leci, trupi gjykues ka ardhë në përfundim se vëllezërit Leci nuk kanë pasë qëllim që ta sulmojnë Hasan Beqirin përsëri, por janë sulmuar nga i pandehuri me armë derisa ata ishin duke shkuar në drejtim të veturës së tyre. Duke pasë parasysh largësinë në mes të viktimave dhe të pandehurit Beqiri, nuk ekziston arsyeja të besohet se sulmi i vërtetë dhe i çastit do të ndërmerrej kundër Hasan beqarit, përkundrazi ishte i pandehuri i cili ka shkaktuar rrezik për vëllezërit Leci. Trupi gjykues ka ardhë deri të përfundimi i qartë jo vetëm në bazë të vlerësimit të mendimit të ekspertëve por shumë edhe nga deklarata e dhanë nga vet Hasan Beqiri. Gjatë marrjes në pyetje me datën 21 maj 2010 para trupit gjykues ai ka deklaruar se: *“unë gjithmonë e kam mbajtur revolen që 45 vite sepse jam marr me tregti dhe në xhepat e mi mund të gjendeshin 5-6 miliona. Nuk i jam frikuar askujt pos Zotit.”* Një qëndrim i tillë i parashtruar nga i pandehuri tregon se pasi që ka pasë armë me vete në ditën kritike, ai nuk i është frikuar nga vëllezërit Leci dhe se vetëm në befasi ka qenë i tërhequr zhagas nga ara. Menjëherë pasi që e ka rimarr veten nga shoku, ai ka vendosë që të merr hak nga vëllezërit Leci për mënyrën se si e kanë trajtuar. Në të vërtetë mënyra se si e ka përdorë armën e vet i pandehuri *“pa e lëvizë armën, por duke e lëvizur vetëm dorën” dhe duke marr parasysh se elementi i sulmit të çastit nuk ka ekzistuar as pak, veprimet të ndërruara nga i pandehuri duhet të vrasje me gjakftohtësi, dhe jo si rasti mbrojtjes së nevojshme.*

Pos kësaj, nuk ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se i pandehuri Beqiri ka tejkalluar mbrojtjen e nevojshme sepse kushtet nga neni 8, paragrafi 3 dhe 4 i kodit penal të Kosovës nuk janë plotësuar.


Sa i përket mendimit të parashtruar nga dëshmitarët ekspert, ky trup gjykues e konsideron si të qartë dhe të besueshëm pasi që ekspertët e kanë prezantuar arsyetimin e qartë, pasi që janë marrë në konsiderim të gjitha provat e administruara gjatë gjykimit. Trupi gjykues është i mendimit se dëshmitarët ekspert duhet të konsiderohen si profesionistë me shumë eksperiencë, të cilët kanë jo vetëm eksperiencë profesionale



dhe histori të gjatë me gjykata si ekspert, por edhe me dijeni të padiskutueshme në fushë të specializimit të tyre.

Provat të cilat kanë qenë me rëndësi fundamentale për të vërtetuar historikun faktik kanë qenë deklaratat e dhëna nga dëshmitarët **Aleksander Trajkovic** dhe **Artan Leci**.

**Aleksandar Trajkovic** ka qenë i pranishëm në vend në ditën kritike pasi që i pandehuri ka kërkuar nga ai që ta lëvront tokën me traktor. Ky dëshmitar ka dëshmuar se tre burra kanë ardhë me veturë nga rruga kryesore dhe janë ndalë afër arës. Ata kanë shkuar në drejtim të Hasan Beqirit dhe ka filluar fjalosja mes tyre dhe të pandehurit. Arsyeja për përparje ka qenë pronësia e tokës. Pasi që ky dëshmitar e ka pa situatën ai ka vendosë që të ikë nga aty pasi që ai ka qenë aty për të punuar me pagesë dhe se ara nuk ka qenë e tija, prandaj ai nuk ka dashtë që të futet në ndonjë rrezik në lidhje me këtë mosmarrëveshje. Para se qi ka shkuar, Aleksandar Trajkovic ka vërejt se: *“debati nxehej. Pas kësaj i kam pa tre persona, njërin pakë ndarazi nga ata dy të tjerët, dy personat e tërhiqnin zhagas personin e tretë nëpër arë”*. Gjatë marrjes në pyetje të [këtij dëshmitari me 10 dhjetor 2010, ishte e qartë për Trupin gjykues se Aleksandar Trajkovicit, pesë (5) vite pas incidentit nuk i kujtoheshin të gjitha detajet, dhe për këtë arsye dëshmia e tij e kaluarë dhanë me 1 gusht 2006 është lexuar për procesverbal. Kur është konfrontuar me këto deklarata, dëshmitari i ka vërtetuar ato dhe ka shtuar se me datën 1 gusht 2006 ai i ka mbajtur detajet më mirë në mend. Gjatë marrjes në pyetje me datën 1 gusht 2006 Aleksandar Trajkovic ka parashtruar një dëshmi të mrekullueshme në lidhje me këtë fjalosje vdekjeprurëse. Ai ka deklaruar këtë: *“Ne jemi kthyer në arë rreth orës 16:00, unë kam filluar të lesoj tokën nga rruga kryesore në drejtim të lakrave, poshtë të rruga fshatare, dhe kam qenë afër kryerjes së herës së parë. Jam kthyer pas për të kontrolluar lesat, i kam pa tre persona që i afroheshin Hasanit dhe kam vërejte se ka pas një diskutim nja një apo dy minuta, dhe në atë moment e kam vërejt veturën afër rrugës kryesore, dhe në atë moment njeri nga tre personat është nisë në drejtim të veturës. E kam kthyer traktorin dhe jam nisë në drejtim të fshatit në rrugicën e vjetër të fshatit, dhe jam kthyer disa herë. Kam shkuar nja 20 metra dhe jam ndalë për një çast, por nuk e kam ndalë motorin e traktorit, dhe në atë moment e kam pa njërin nga ata duke ardhë në drejtim timin. Kam vërejt se si Hasani i thoshte diçka atij dhe ai e ka ngitë dorën e tij, dhe nga gjestet, më duket se Hasani i thoshte mos me më prekë mua sepse unë nuk kam faj. Ai që ishte nisur nga unë është kthyer në drejtim të Hasanit dhe kanë vazhduar diskutimin dhe mandej njeri nga ata është nisur në drejtim të rrugës kryesore. Ata dy të tjerët e kanë kapë Hasanin dhe e kanë tërheq zhagas sikurse të dëshironin ta nxjerrin nga ara në rrugicën e fshatit, por në atë moment, unë nuk e kam pa të tretin afër.”* Pos kësaj ai ka deklaruar: *“kur e kam pa Hasanin që është rrëzuar për toke, në kanal, unë menjëherë jam nisur për në shtëpi, sepse jam frikuar për sigurinë time, dhe pas pakë kohe, rreth 2-3 minutash, afër Selishtes (emri i vendit), i kam dëgjuar tri të shtëna që janë shti pa pushime të gjata, njeri menjëherë pas tjetrit. Pas të shtënave, unë për*



***shkurtazi jam kthyer edhe një herë i kam pa se dy njerëz ishin të shtrirë për toke deri sa i treti ishte në këmbë.”***

Kjo dëshmi e parashtruar nga ana e Aleksandar Trajkovic është rëndësisë së posaçme pasi që ai ka qenë i pranishëm në vend dhe ka pasë kushte optimale të shikoj nga afërsia rrjedhën e ngjarjes. Në atë kohë të ditës, rreth orës 16:00 shikueshmëria ka qenë e mirë dhe dëshmitari ka qenë në një largësi prej 50 dhe 100 metrash, sipas deklaratës së tij, dhe prandaj e ka pa incidentin dhe ka pasë mundësi të parashtroj ate çka ka ndodhur si dëshmitar i dorës së parë në mënyrë të kuptueshme. Dëshmia e Aleksandar Trajkovic është konsideruar nga ana e Trupit gjykues si shumë e besueshme jo vetëm pse ka qenë dëshmitar okular por edhe pse deklarata e tij ka qenë e qartë, jo me dy kuptime dhe e paanshme. Edhe pse Aleksandar Trajkovic e përshkruan marrëdhënien e tij me fqin e tij Hasan Beqiri si të mirë, ai nuk ka dhanë dëshmi e cila do ti përshtatej pohimeve mbrojtëse të Hasan Beqirit. Posaçërisht ai nuk ka deklaruar se e ka pa ndonjërin nga vëllezërit Leci të jenë afruar të pandehurit me kaçavidë që do të ishte me rëndësi për tentimin e Hasan Beqirit të vërtetoj se ai ka vepruar nën kushtet e mbrojtjes së nevojshme.

Përkundrazi, gjatë dëshmisë në seancën kryesore të mbajtur me datën 12 janar 2007 dëshmitari ka deklaruarën mënyrë të saktë ndaj pyetjes së përfaqësuesit të palës së dëmtuar, se a e ka vërejt të kenë pasë këta tre persona ndonjë armë, armë të ftohët apo ndonjë mjet tjetër, se ai nuk ka pa se ata kanë pasë diçka në duart e tyre. Në pyetjet në lidhje me rrjedhën e ngjarjes ai më tej ka dhanë sqarime duke pa dy nga tre personat të cilët e kanë shty apo ndoshta tërheqë të akuzuarin, *Nuk e di se cila është*, por një nga këto veprime është ndërmarr nga ata për të larguar të akuzuarin nga ara në rrugë. Kjo dëshmi e detajizuar dhe e saktë demonstroi se Aleksandar Trajkovic e ka parashtruar dëshminë e cila ka qenë plotësisht e besueshme pasi që Trupi gjykues nuk ka vërejt ndonjë dallim në mes të dëshmimeve të tij të dhëna gjatë gjykimit dhe hetimeve. Pasi që Aleksandar Trajkovic nuk është në lidhje familjare as me të pandehurin dhe as me palën e dëmtuar, ai nuk ka pasë interes personal që të jap dëshminë ashtu si e ka dhanë. Edhe pse gjatë rigjykimit Aleksandar Trajkovic nuk i janë kujtuar të gjitha detajet me saktësi kjo është plotësisht normale, pasi që kujtesa i është humbur për shkak se shumë kohë ka kaluar. Kjo rrethanë nuk e zvogëlon vlerën e dëshmisë të cilën e ka dhanë Aleksandar Trajkovic edhe pse gjatë ngjarjeve ai ka qëndruar në traktor, sepse është e qartë se ai ka mund ti shoh ngjarjet.


Deklarata e dhanë nga **Artan Leci** gjithashtu ka rëndësi të lartë për të vërtetuar historikun faktik të këtij rasti. Artan Leci është vëllai i të ndjerëve dhe ai ka ardhë së bashku me ta në arën kontestimore në ditën kritike. Gjatë vlerësimit të dëshmisë së tij, trupi gjykues ka pasë kujdes të madh, pasi që dëshmitari si palë e dëmtuar, dhe pjesëmarrës në këtë incident tragjik do të kishte arsye për ta fshehë të vërtetën. Pas shqyrtimit të kujdesshëm, Trupi gjykues ka ardhë në përfundim se dëshmia e Artan Lecit



është e besueshme vetëm për pjesën kur kanë ardhë në arë me vëllezërit e vet në ditën kritike dhe vëllezërit e tij janë vra nga ana e të pandehurit. Sa i përket rendit të ngjarjeve, Trupi gjykues ka ardhë në përfundim se dëshmia e Artan Lecit nuk është as pak e besueshme. Në këtë respekt ato janë në kontradiktë me provat të hollësishme nga dëshmia e qartë e Aleksandar Trajkovic dhe mendimet e parashtruar nga dëshmitarët ekspert. Po kësaj, Trupi gjykues ka vërejt disa dallime serioze në mes të dëshmimeve të parashtruara nga ky dëshmitar gjatë procedurës penale. Sa për sqarim duhet të përmendet një situatë. Me 10 dhjetor 2009 Artan Leci ka dhanë dëshmi para trupit gjykues në lidhje me rrjedhën e ngjarjeve në ditën kritike. Në deklaratën e tij ai ka thanë se kanë ardhë në arë për të mbledhë 90 kg. Purri. Po sa kanë mbërri në arë, ata kanë dalë nga vetuar dhe traktoristi ka ikur nga toka. Në atë moment, papritur një njeri ka dalë nga barishtet. Ai i është afruar vëllezërve leci në largësi prej 4 – 5 metrash pa kuruar arsye; e ka nxjerrë revolen nga brezi dhe ka filluar të shtie me te. Sipas këtij dëshmitari ky njeri nuk ka thanë asgjë para se ka filluar të shtie dhe as vëllezërit Leci nuk kanë pas rast që të flasin me te. Ai ka deklaruar gjithashtu se kur ky njeri ka filluar të shtie; vëllezërit Leci nuk kanë pasë asnjë armë në duart e tyre. Ai dhe vëllezërit e tij kanë qenë në një largësi prej 1 – 2 metrash nga njeri tjetri, ata kanë qenë në një vij duke ecur kah arra ku ishin purritë. Artan Leci ka mohuar se ky njeri ka shtie në ajër. Pasi që Ardian dhe Dritan Leci kanë ra në tokë, i pandehuri ka shku në drejtim të rrugës së asfaltuar dhe mandej ate e kanë marrë me një veturë të kuqe. Mandej Artan Leci e ka organizuar bartjen e vëllezërve të tij të plagosur në spital.

Deklarata e dhanë para gjykatës ishte në kundërshtim me dy dëshmitë e parashtruara nga ky dëshmitar gjatë hetimeve dhe gjatë gjykimi të parë. Në pyetjet gjatë intervistës me 23 maj 2006 ai ka deklaruar: *“Më kujtohet se me 10.10.2005, diku rreth orës 16:00, vëllezërit e mi Ardian, Dritani dhe unë shkuam nga shtëpia jonë në Barilevë me një Golf 2 në këtë arë në fshatin Babimost për të marrë pakë purri dhe për ti shitur në treg. Kur kemi mbërri në arë në Babimost, që është larg nga fshati jonë rreth 5 kilometra, dhe besoj se mund të arrihet atje me 20 minuta vozitje, që të tre dolëm nga vetura dhe e kemi vërejt vozitësin e traktorit i cili ishte në arë, dhe ne shkuam te ai dhe **Dritani e ka pyetur se çka po ban ai këtu**, por ai nuk është përgjigj por vetëm ka dalë nga ara me traktor dhe ka shku.”* Versionin e njejtë të ngjarjes të cilin ai e ka parashtruar gjatë hetimeve, ai e ka parashtruar edhe me datën 12 janar 2007 para trupit gjykues kur ka shpjeguar: *“Largësi në mes të vendit ku e kemi ndalë veturën dhe traktorit ka qenë 60 metra. Dy vëllezërit e mi dhe unë shkuam në drejtim të vozitësit të traktorit që të shihem se kush ishte ai. Kur jemi afruar në 10 metra nga traktori, dhe në ndërkohë vëllai im e pyeste vozitësin e traktorit se çka po bënte këtu, traktori ka shkuar në rrugën fushore në drejtim të fshatit Babimost.”*

Kur është kërkuar sqarimi për këtë kontradiktë evidente, ai ka qëndruar pranë deklaratës që e ka parashtruar gjatë gjykimit dhe ka shtuar se dëshmia para prokurorit në lidhje me këtë detaj është rezultat i gabimit, të shkaktuar me kompjuter. Ky Trup




grykues nuk e ka konsideruar këtë sqarim si bindës, pasi që është shumë i paqartë. Artan Leci ka pasë mundësi që të lexoj dëshminë, të kundërshtoj përmbajtjen dhe të kërkoj që të shtohem komente në përputhje me dëshminë e tij origjinale. Pasi që ai nuk e ka ba këtë, ai nuk mund të parashtrroj këtë argument me sukses.

Në fund, duhet të nënvizohet se Artan Leci si vëlla i të pandehurve dhe dëshmitar okular i kësaj ngjarje tragjike dëshiron që ti prezantoj vëllezërit në dritë më të favorshme. Kjo është arsyeja pse ai e ka fshehtë të vërtetën për rrjedhën e ngjarjes. Ai nuk e ka parashtruar faktin se Hasan Beqiri është tërheq zhagas nga ara pasi që ai ka menduar se kjo mund të përdoret kundër si argument kundër vëllezërve të tij të ndjerë.

Gjithashtu, dëshmia e dhanë nga Artan Leci është në kundërshtim jo vetëm me dëshminë e Aleksandar Trajkovic i cili si i huaj nuk ka pasë asnjë arsye personale që të jep ndonjë deklaratë të pabesueshme, por edhe me mendimet e dëshmitarëve ekspert.

Duke marr parasysh deklaratën e **Rahman Lecit**, ky Trup grykues ka vërejt se ai nuk ka qenë i pranishëm gjatë ngjarjes dhe të gjitha informatat që i ka, i ka marrë nga Artan Leci, prandaj të gjitha dyshimet që janë shprehë ndaj Artan Lecit vlejné edhe për këtë. Dëshmia e Rahman Lecit ka qenë shumë e rëndësishme në lidhje me pronësinë e kësaj are kontestuese. Rahman Leci ka rrëfyer se me 17 janar 2001 ai e ka marrë me qira këtë tokë për pesë vite për 100 DM në vit. Në një moment bijtë e tij e ndërruan marrëveshjen me pronarin dhe i kanë paguar atij 40.000 DM, ndërsa pjesën tjetër të pagesës është dashtë të paguhet brenda pesë vitesh dhe mandej toka do të jetë pronë e familjes Leci. Ata e kanë ba këtë marrëveshje me gojë, pa pasë kontratë të shkruar. Rahman Leci e konsideron familjen e tij si pronarë të vetëm të kësaj toke. Në vitin 2005 familja Leci dy herë e ka vendosë tabelën me informatë se toka shitet, pasi që ata donin ta shesin një pjesë të saj dhe nga ato para ta bëjnë pagesën për pjesën e mbetur të borxhit. Rahman Leci ka pranuar se çështja e cila ka qenë me rëndësi shumë të madhe për vlerësimet e kësaj lënde është pronësia e arës që ka qenë kontestuese pasi që ka qenë edhe një person tjetër që quhet Hajzer Mustafa i cili ka qenë gjithashtu i interesuar për ta blerë këtë tokë. Sipas këtij dëshmitari, më herët, para se ky incidenti ka ndodhur, Hajzer Mustafa e ka informuar se ai gjithashtu e ka ble këtë tokë nga Dragoljub Lazic. Ai është tërheqë nga kjo kontratë pasi që ka kuptuar se familja Leci pohon se ata janë pronarë të kësaj toke.

Pas marrjes në konsiderim të të gjitha rrethanave në lidhje me kontestin për pronësi të kësaj toke, ky Trup grykues ka ardhë deri te përfundimi i vetëm i mundshëm logjik se vëllezërit Leci kanë shkuar në vend nga dëshira për ta nxjerr jashtë personin e pftuar nga toka e tyre. Sqarimi i përdorur nga Artan Leci dhe mandej i konfirmuar nga Rahman Leci është se ata dëshironin të mbledhin purri, dhe për shkak të Ramazanit ata kanë shkuar atje tre veta për ta kryer këtë shpejtë, nuk është aspak i besueshëm. Mbledhja e purrive nuk merr shumë kohë dhe nuk kërkon prezencën e tre burrave të rinj dhe të



shëndoshë. Është e qartë se kjo është përdorë si argument për justifikimin e pranisë së vëllezërve Leci në atë vend në atë kohë.


Dëshmitë e parashtruara nga dëshmitarët **Mladen Lazic, Dragoljub Lazic dhe Hajzer Mustafa** janë konsideruar nga ky Trup gjykues si të besueshme pasi që janë logjike të arsyeshme dhe në detaje. Këto dëshmi kanë qenë me rëndësi shumë të madhe pasi që përputhen me konkludimet faktike në lidhje me pronën kontestuese, arën. Nga këto dëshmi shihet se edhe familja Leci ka qenë e interesuar për ta ble këtë arë. Duke i marr parasysh këto rrethana arsyeja e vetme e mundshme dhe logjike se pse vëllezërit Leci kanë shkuar te ara në ditën kritike, është se kanë dashtë që ti nxjerrin jashtë personat e pafuar nga toka e tyre.

Pasi që i pandehuri pretendon se mbrojtja e nevojshme duhet të merret në konsiderim, trupi gjykues ka vendosë që ti pranojë si prova dëshminë e këtyre policëve që janë përfshirë gjatë hetimeve: **Remzi Halimi, Bekim Gashi, Blerim Gashi dhe Burim Osmanaj.**

**Remzi Halimi** ka qenë i pranishëm në vend pas orës 18:00 dhe e ka përgatitë dhe nënshkruat Raportin e forensikës /Sektori për vend të ngjarjes, i datës 14 tetor 2005 me nr. Ref. MHQF 05-2288. Gjatë marrjes në pyetje me datën 8 prill 2010, ai ka deklaruar se kur ka mbërri te vendi i ngjarjes është terruar dhe ka qenë vështirë të shihet vendi i ngjarjes. Ai ka vërejt vetëm njollat e gjakut, dhe veprimet tjera hetuese janë shtyrë deri të nesërmen. Të nesërmen ai ka shkuar atje së bashku me Bekim Gashin dhe kanë vazhduar të mbledhin prova për këtë rast. Ky dëshmitar ka deklaruar se gjatë mbledhjes së provave ai nuk ka gjetë kaçavidë me gjatësi 35 apo 45 cm me dorëz të kuqe.

Dëshmitari **Bekim Gashi** gjithashtu ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes dhe ka folë për veprimet hetuese të cilat i ka ndërmarrë së bashku me policët tjerë. Ai ka sqaruar në detaje se si janë mbledhur provat dhe ka shpjeguar se ai nuk ka gjetë në atë vend kaçavidë apo diçka tjetër që ja ka tërheq vëmendjen. Gjithashtu ai ka shtuar se vendi i ngjarjes është ruajtur gjatë natës nga policët nga Stacion policor i Obiliqit. Dëshmitari **Blerim Gashi** ka shpjeguar rrethanën shumë të rëndësishme të konfiskimit dhe ekzaminimit të veturës së viktimave dhe ka deklaruar se Polici Ekrem Mirena ka qenë përgjegjës për kryerjen e këtyre detyrave. Sipas Blerim Gashit, ai nuk ka dëgjuar se ndonjë mjet i rrezikshëm sikurse kaçavida është gjetë në këtë veturë. **Burim Osmanaj** e ka përgatitë Raportin penal në këtë rast, ai ka parashtruar disa informata në lidhje me veprimet e ndërmarra nga hetuesit.

Trupi gjykues ka ardhë në përfundim se Remzi Halimi, Bekim Gashi, Blerim Gashi dhe Burim Osmanaj të besueshëm, pasi që janë të qartë, logjik dhe korrespondojnë me njëri tjetrin. Gjithashtu, ky Trup gjykues nuk ka vërejt ndonjë mospërputhshmëri në mes tyre. Dëshmitarët janë oficer të policisë dhe si të tillë ata kanë qenë dijeni për përgjegjësinë penale në rast të dhënies së dëshmisë së rrejshme. Dëshmitë e dëshmitarëve të




lartpërmendur i ka dhanë mundësi këtij Trupi gjykues që të vërtetoj mbi çfarëdo dyshimi të arsyeshëm se as në vendin e ngjarjes dhe as në veturën e viktimave nuk është gjetë ndonjë kaçavidë. Kjo situatë i rrënon themelet e pohimeve të të pandehurit në dëshminë s tij se ai ka qenë i ballafaquar me situatë kërcënuese sepse gjoja se kaçavide do të ishte përdorë kundër tij si armë vdekjeprurëse. Dëshmitë e këtyre policëve qartazi demonstrojnë se i pandehuri e ka përgatitë mbrojtjen me kaçavidë si pjesë të rëndësishme të saj, vetëm nga një arsye e dukshme – ai dëshironte ti shmangët përgjegjësisë së tij penale për veprat vdekjeprurëse që ai ika kryer.

Mbrojtja është munduar që ta tërheq vëmendjen e këtij Trupi gjykues te çështja e distancës nga e cila i pandehuri ka shti në viktimat, duke ndikuar nevojën për ekzaminim të mëtejme të mostrave të barotit të mbledhura nga duart e viktimave dhe rrobat të cilat viktimat i kanë pasë të veshura në ditën e incidentit. Gjykata i ka pranuar si prova Raportet laboratorike nr. 2010-0321 të datës 9 prill 2010 me nr. të referencës 511-01-115/1-2545/10.VN nga Republika e Kroacisë, Qendra shkencore e forensikës, “Ivan Vučetić”, departamenti i traseologjisë nga shefi i Departamentit Vedran Nuić, B.Sc, por pa përdorim. Nuk ka qenë pengesë për trupin gjykues që të bëjë konstatim faktik pa dy kuptime pasi që eksperti Hazir Kelmendi ka ardhë deri te konkluzioni bindës sa i përket kësaj.

Ky Trup gjykues i ka kushtuar kujdes të veçantë fotografive të parashtruara nga ana e mbrojtjes me qëllim që të ilustrojnë lëndimet të cilat gjoja se i pandehuri i ka pësuar gjatë këtij incidenti tragjik. Trupi gjykues ka ardhë në përfundim se këto fotografi nuk mund të merren në konsiderim si provë e besueshme. Së pari duhet të theksohet se asnjëra nga fotografitë nuk e tregojnë fytyrën e të pandehurit, fytyra nuk i shihet, së dyti, fotografitë janë të kualitetit të dobët dhe e paqartë, dhe në fund, prapa fotografisë shihet data “3.11.2005”, pra janë zhvilluar një muaj pas incidentit. Përfundimi i vetëm i mundur se këto fotografi janë plotësisht të sajura me qëllim të qartë që të përdoren si prova se i pandehuri është rrahur seriozisht, për të mbështetë pohimet e tija të mbrojtjes së nevojshme që do ti mundësonte pohimin se për ti ju shmangë sulmit tjetër i është dashtë të përdorë armën e tij. Trupi gjykues nuk dëshiron të kufizoj të drejtën e të pandehurit për të përgatitë mbrojtjen e tij në mënyrë që ai beson se është më së mirë për te, por ai nuk duhet të pres së çfarëdo prove që e parashtron të merret si e besueshme. Ky trup gjykues eka pasë për obligim që ti shqyrtoj të gjitha provat e mbledhura gjatë gjykimit në hollësi, gjatë shqyrtimit ligjor dhe të bie aktgjykim të drejtë, por fatkeqësisht për të pandehurin prova që ai e ka parashtruar nuk e ka arrit nivelin e besueshmërisë së pakontestueshme.

### Llogaritja e dënimit



Pas shqyrtimit të provave të lartpërmendura dhe pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve që janë ftuar gjatë procedurës, Gjykata ka konkluduar se Hasan Beqiri është i fajshëm mbi çfarëdo dyshimi të arsyeshëm për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar me aktakuzë.


Është e qartë se i pandehuri e ka kryer veprën penale nga neni 147, paragrafi 1, pika 11 të Kodit penal të Kosovës, dhe se me 10 tetor 2005, rreth orës 16:00, në fshatin Babimost, Komuna e Obiliqit, në një parcelë të tokës që gjendet në rrugën kryesore Prishtinë – Mitrovicë, me dashje, pas një fjalosje të çastit e ka vra Ardian Lecin dhe Dritan Lecin. Në ditën kritike i pandehuri ka qenë duke e lëvruar dhe farëzuar grurë me ndihmën e vozitësit të traktorit Aleksandar Trajkovic. Kishte filluar një mosmarrëveshje verbale në mes të Ardian, Dritan dhe Artan Leci dhe the pandehurit Hasan Beqiri në lidhje me pronësinë e tokës në fjalë. Pas mosmarrëveshjes me fjalë, i pandehuri është tërheqë zhagas nga viktimat prej arës deri te skaj i rrugës. I pandehuri pasi që është ndier i çnderuar e ka përdorë revolen e tij "TT" të kalibrit 7,62 x 25mm, pa leje valide, nga distanca prej afërsisht 6 – 7 metrash, duke shti tre (3) herë në drejtim të ndjerit Ardian Leci, dhe si konsekuencë plumbat (2) kanë shkaktuar plagë hemorogjike, ndërprerjen e funksionimit të aortës, penetrimin e perforuar të plumbit në gjoks dhe bark, dhe si konsekuencë e të cilave ai ka vdekur me 11 tetor 2005 rreth orës 03:05, dhe në drejtim të Dritan Lecit ndaj të cilit me një plumb i pandehuri ka shkaktuar plagë në kokë dhe gjoks, dhe si pasojë e shokut, hemorragjisë dhe plagës penetruese, Dritan Leci ka vdekur me 10 tetor 2005 rreth orës 17:30.

Në bazë të nenit 147, paragrafi 1, pika 11 të Kodit penal të Kosovës, do të shqiptohet dënimi prej së paku dhjetë vjet burgim apo burgim afatgjatë kryesit të këtij lloji të veprës penale.

Gjithashtu, i pandehuri Hasan beqari, e ka kryer veprën penale Pronësia, posedimi, kontrolli ose përdorimi i paautorizuar i armëve, pasi që për një kohë të pacaktuar deri me datën 10 tetor 2005, ka poseduar revolen "TT" të kalibrit 7,62 x 25mm, pa leje valide për posedim dhe përdorim.

Në bazë të nenit 328, paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës, ndaj kryesit të kësaj vepre penale do të shqiptohet dënimi me të holla deri në 7.500 EUR apo dënimi me burg prej një deri në dhjetë vjet.

Në bazë të nenit 64 (1) të KPK gjatë matjes së dënimi, Gjykata duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë, motivet për kryerjen e veprës, intensiteti i rrezikshmërisë ndaj vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjellja e kryesit në të kaluarën, rrethanat personale, dhe sjellja e kryesit pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit.



1. Si rrethana lehtësuese:

- I akuzuari ka shprehë pikëllim për vdekjen e dy viktimave;
- I pandehuri i ka 68 vjet.

2. Si rrethana rënduese:

- Intensiteti i lartë për rrezikshmërinë ndaj vlerave të mbrojtura sikurse që janë: jeta e qenies tjetër njerëzore, si konsekuencë i veprës penale Ardian Leci dhe Dritan Leci kanë humbë jetët e tyre, fëmijët e tyre jetimë;

Duke i marr të gjitha këto rrethana parasysh me shumë kujdes, ky Trup gjykues ka ardhë në përfundim se dënimi me burg pre njëzet e dy (22) vjet do të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për ti përmbushur të gjitha qëllimet e dënimit nga neni 64 (1) të KPK në lidhje me vrasjen e rëndë.


Duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura, Trupi gjykues ishte i mendimit se kryesi i veprës penale nuk e ka merituar të trajtohet më lehtë. Kjo sjellje të cilën i pandehuri e ka prezantuar duhet të dënohet rreptësishtë. Në këtë rast vetëm dënimi me burgim pa kusht, do të garanton se do të arrihet qëllimi i dënimit kundër kryesit të veprës penale, dhe posaçërisht se ai nuk do të përsëris veprën penale. Ky dënim do të bindë të pandehurin se ligji duhet të respektohet.

Sa i përket veprës penale Pronësia, posedimi, kontrolli ose përdorimi i paautorizuar i armëve, ky Trup gjykues ishte i mendimit se burgimi me një vjet do të ishte i përshtatshëm dhe i nevojshëm për ti përmbushur të gjitha qëllimet e dënimit nga neni 64 (1) të KPK.

Në bazë të nenit 71, paragrafi 1 dhe 2, pika 1 të Kodit penal të Kosovës, ky Trup gjykues ka konkluduar se Hasan Beqiri do ti nënshtrohet dënimit unik me burgim prej njëzet e dy (22) vitesh.

Në bazë të nenit 73 të Kodit penal të Kosovës, kohën të cilën Hasan Beqiri e ka kaluar në paraburgim nga 10 maji 2006 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit do ti llogaritet si pjesë dënimit me burgim.

**Kërkesa pronësoro juridike**



I akuzuari do ti kompensojë palëve të dëmtuara Rrahman dhe Artan Leci dëmet e shkaktuara. Shënimet e siguruar gjatë procedurës penale nuk paraqesin bazë reale as për kompensimin e plotë as të pjesshëm; prandaj Gjykata e udhëzon palën e dëmtuar që të parashtron padi civile për kërkesën e plotë sipas nenit 112 (2) të KPK.

### Shpenzimet

Në përputhje me nenin 102 paragrafi 1 Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK) personi i dënuar do të paguaj shpenzimet e procedurës. Dispozita e nenit 100, paragrafi 1 i KPPK thekson se i pandehuri duhet të kompensoj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej treqind (300) Euro, për shkak të veprave penale Vrasje e rëndë nga neni 147, paragrafi 1, pika 11 i KPK dhe Pronësia, posedimi, kontrolli ose përdorimi i paautorizuar i armëve, nga neni 328, paragrafi 2 i KPK.

Prandaj kështu është vendosur sikurse në dispozitiv.

Kryetari i Trupit gjykues

Anëtari i Trupit gjykues

Anëtari i Trupit gjykues

Arkadiusz Sedek

Hamdi Ibrahim

Malcolm Simmons

Procesmbajtës:  
Svetoslava Savova

### UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë Gjykatës supreme të Kosovës përmes Gjykatës së qarkut në Prishtinë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të një kopje të Aktgjykimit, në bazë të nenit 398, paragrafi 1 të kodit të Procedurës penale të Kosovës (KPPK).

